



Data: 16/07/2019

Ref.: 1275/19D

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L0031, datë 25.05.2016), nenit 7 dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2019, Nr. 08/2019 dhe Nr. 13/2019 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ Nr. 15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 73-të dhe 74-të, të mbajtur më 18.06.2019 dhe 15.07.2019, mori:

V E N D I M

Për korrigjimin (ndryshimin) e vendimit Ref.: 425/12, datë 09.07.2012, dhe vendimit nr. 829/15 datë 31.08.2015 të Universitetit të Prishtinës, Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës

I. Korrigjohet (ndryshohet) vendimi i KSHC-së Ref.: 425/12, datë 09.07.2012 dhe vendimit nr. 829/15 datë 31.08.2015, të Universitetit të Prishtinës, Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, pika nr. I, 1.4, Arkitekturë MSc, përmirësohet si në vijim: I. Arkitekturë BSc 180 ECTS, II. Arkitekturë MSc 300 ECTS.

A r s y e t i m i

I. Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës, përmes shkresës nr. 1244/19H ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për përmirësim të vendimit nr. 425/12 datë 09.07.2012, dhe vendimit nr. 829/15 datë 31.08.2015.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e mbajtur më 18.06.2019 dhe 15.07.2019 ka shqyrtuar kërkesën e Universitetit të Prishtinës, Fakulteti i Ndërtimtarisë dhe Arkitekturës. Pas analizimit të aplikacionit të dorëzuar dhe raportit të ekspertëve ndërkombëtar, KSHC arriti në përfundimin se ky institucion ka aplikuar për akreditim të programit Arkitekturë për nivelin Bachelor dhe nivelin Master (studime të integruara). Si i tillë ky program është vlerësuar edhe nga ekipi i ekspertëve ndërkombëtarë, i cili rekomandon që programi të ofrohet si nivel Bachelor me 180 ECTS, dhe program i integruar Master me 300 ECTS.

Duke u bazuar në aplikacionet e dorëzuara nga vetë institucioni dhe duke u bazuar se i njëjti është vlerësuar si i tillë edhe nga ekipi i ekspertëve, KSHC mori vendim si në dispozitiv.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi mund të paraqitet ankesë sipas Nenit 125 dhe 126 të Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative (Nr. 05/L-031, datë 25 Maj 2016). Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerrë këtë vendim bazuar në Nenin 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas Nenit 127 të LPPA.

Vendimi iu dërgohet:

- Universitetit të Prishtinës;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.



Prof. Dr. Gazmend Luboteni
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

